

VENDIM
Nr.54, datë 28.1.2005

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR DHËNIEN E LEJEVE PROFESIONALE
SPECIALISTËVE QË KRYEJNË PROJEKTIMIN, VLERËSIMIN, KONSULENCËN,
MONITORIMIN DHE DREJTIMIN TEKNIK TË VEPRIMTARISË MINERARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 20 të ligjit nr.7796, datë 17.2.1994 “Minerar të Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Leja profesionale për veprimtari minerare, në tërësi, për projektimin, vlerësimin, konsulencën e monitorimin, t’u jepet specialistëve, të cilët plotësojnë këto kushte:

- a) Të jenë diplomuar në degët që lidhen me këtë veprimtari;
- b) Të kenë vjetërsi në punë jo më pak se 5 vjet;
- c) Të jenë autorë ose bashkautorë në tri projekte të miratuara e të zbatuara.

2. Leja profesionale të jepet nga një komision i posaçëm, i cili ngrihet me urdhër të ministrit, që mbulon industrinë minerare. Përbërja dhe mënyra e funksionimit të këtij komisioni përcaktohen me rregulloren përkatëse të miratuar nga ministri, që mbulon industrinë minerare.

3. Specialistët që plotësojnë kriterin e përcaktuar në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij vendimi, por nuk përmbushin kërkesat e tjera, mund të pajisen me leje profesionale vetëm për drejtimin teknik të shoqërive, që ushtrojnë veprimtari minerare.

4. Leja profesionale është personale, përtërihet në çdo pesë vjet dhe regjistrohet në regjistrin themeltar të lejeve profesionale.

5. Ngarkohet Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano